



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:295285

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05569691

C.nr. 1608/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q.B nga P rr. “....” dhe Ndërtimi Sh.P.K. me ne seli në P me numër të Biznesit 70366011 rr. “....” nr..., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. V.K nga P, kundër të paditurës K.P.M dhe M – rr. “.....” nr.... P, me objekt kontesti kompensim dëmi dhe pasurim i pa bazë, me vlerë të kontestit 57,030.16 €, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqësve, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 18.03.2024, ndërsa me datë 12.04.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET** kërkesëpadia e paditësve Q.B nga P rr. “....” dhe N. Sh.P.K. me në seli në P me numër të Biznesit 70366011 rr. “.....” nr..., me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura K.P.M dhe M – rr. “.....” nr... P, që paditësit Q.B nga P emër të kompensimit të dëmit jo material – cenimin e dinjitetit personal ti paguaj shumen prej 15.000.00 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumen prej 800.00 euro, paditëses N. Sh.P.K. me ne seli në Pejë, në emër të dëmtimit ti reputacionit të firmës shumen prej 30,000,00 euro, në emër të pasurimit pa bazë – kthimin e shumës të inkasuar në procedurë përmbarimore P.nr. 215/19 shumen prej 6.616,06 euro, në emër të citimit të humbur, për shkak të ndërprerjes së punimeve për periudhën 05.09.2017 deri me 15.09.2017, shumen prej 5.069,10 euro, e të gjitha këto me kamat 8% duke filluar nga data 20.12.2019, si datë e parashtrimit të padis e deri në pagesën definitive e të gjitha në afate prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit, **në tersi si e pa bazuar.**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim dëmi dhe pasurim i pa bazë, me vlerë të kontestit 57,030.16 €, e të precizuar me parashtrësën e datës 12.01.2024.

I autorizuari i paditësve me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: me administrimin provave dhe me ekspertizat e kryera është vërtetuar në tersi baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, e precizuar si në parashtresën e dt. 12.01.2024. është vërtetuar se e paditura pa bazë ligjore ka shqiptuar dënime dhe dëme, të cilat i ka inkasuar në procedurën përmbartimore P.nr. 215/19, e të cilat shuma në kuptim të aktgjykimit penal janë inkasuar pa bazë ligjore pasi që e paditësi është shpallur i pafajshëm lidhur me veprën penale nga neni 347 i KPRK e që ka pasur të bëjë me aktvendimin e të paditurës nr. 4186 i dt. 22.09.2017. andaj bazuar në nenin 450, 452, 454 të KPRK-së dhe nenin 183 të LMD-së dhe ekspertizave të kryera e paditura detyrohet në pagesën e dëmeve të precizuara si në petitum të kërkesëpadisë së dt.12.01.2024, po ashtu shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

I autorizuari i të paditurës me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: qëndrojmë pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve të bëra në seancat e kaluara, si dhe kërkojmë nga ana gjykata që padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar, pasi që sipas provave të cilat i kemi dorëzuar gjatë zhvillimit të procedurës, është vërtetuar se ndërmarrja është ende e pa licencuar ndaj KPMM, e po ashtu si provë kemi dorëzuar edhe aktgjykimin ku nga e njëjta gjykatë është shpallur fajtor, shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: Urdhri për inkasimin e borxhit P.nr. 215/19 e dt. 30.08.2019, aktgjykimi P.nr. 1127/17 i marre nga GJTH në Pejë, kallëzimi penal kundër Q.B, Raporti për aktivitetin të jashtëligjshëm me nr, 10805 i dt. 07.09.2017, Urdhëresa për ndërprerjen e aktivitetit drejtuar N Sh.p.k, Raporti mbi kalkulimin e vëllimit i dt. 18.09.2017, Raporti për operim ilegal i dt. 18.09.2017, kallëzimi penal për Q.B dt. 08.11.2018, Raporti për aktivitetin të jashtëligjshëm minerarë i dt. 29.10.2018, Urdhëresa për ndërprerje e Aktiviteteve të jashtëligjshme minerarë i dt. 22.10.2018, Raporti i aktivitetit të jashtëligjshëm minerarë me nr. protokollin 10920 i dt. 22.10.2018, Urdhëresa për ndërprerje e aktiviteteve të jashtëligjshme minerarë i dt. 22.10.2018, Ekspertiza financiare e punuar nga U.S, Ekspertiza e psikologut S.K, Aktgjykimi P.nr. 898/18 i marre nga GJTH në P, Aktvendimi me nr. protokollin 4186 i dt. 22.09.2017 bashkë me flete këthese, Aktvendimi me nr. KA nr. 010/2018 i dt. 16.01.2018 bashkë me fletë këthese, Aktvendimi me nr. 2055 i dt. 23.07.2012, Aktvendimi i KPMM i dt. 08.07.2020 bashkë me flete këthese, aktvendimi nga KPMM me nr. Protokollin 1748 i dt. 23.05.2022 bashkë me fletë këthese, Aktvendimi i KPMM me nr. Protokollin 4173 i dt. 09.11.2018, Raporti për obligimet e bazuara me nr, protokollin 6176 i dt. 02.11.2023

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se e paditura kishte parashtruar kallëzim penal ndaj paditësit të parë Q.B e ku ndaj të njëjtit P.TH Pejë kishte ngritur Aktakuzë

me numër 2287/17 të datës 02.11.2017, e cila Aktakuzë ishte refuzuar nga ana e Gjykatës Themelore në Pejë me Aktgjykimin P.nr. 1127/17 të datës 12.12.2019.

Palët paditëse pretendojnë se me rastin e paraqitjes së kallëzimit penal të njëjtëve i është shkaktuar dëme për çka edhe për të vërtetuar lartësinë e dëmeve gjykatës i kane propozuar që të mirëtohen prova me ekspertizë financiare ku gjykata me aktvendimin e datës 07.03.2022 ka caktuar ekspertin financiar U.S dhe i njëjti në ekspertizën datës 21.03.2022 ka konstatuar se: fitimi i mundshëm i humbur për shkak të ndërprerjes së punimeve subjektit (paditëses së dytë N Sh.P.K. me ne seli në Pejë) në periudhën nga data 05.09.2017 deri me datë 15.09.2017, sipas përllogaritjeve së kryera në ekspertizë kap shumen prej 5,069.10 euro.

Gjykata i fali besimin ekspertizës financiare pasi që e njëjta ishte punuar në mënyre profesionale duke dhen sqarime të mjaftueshme edhe për lartësinë, gjithashtu palët nuk kishin paraqitur kundërshtime në ekspertizë.

Gjithashtu sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse gjykata ka marr provën me ekspertizë nga lëmia e Psikologut S.K ku i njëjti në ekspertizën e tij kishte konstatuar se: u padituri Q.B është përgjithësisht person i shëndetshëm, nuk ka vuajtura asnjëherë sëmundje të renda, për moshën e tij ai ka një gjendje të mire shëndetësore megjithatë për shkak të stresit, lodhjes dhe nervozizmit të lidhur për punën e tij , ai ka vizituar një psikiatër për terapi qetësues, ku ka deklaruar se nuk ka pasur asnjëherë konflikt personal me ligjin dhe rregulloret ligjore si dhe konfliktet në mjedisin ku ai punonte e po ashtu as familja e tij nuk ka pasur ndonjë konflikt dhe as ndonjë marrëdhënie të prishur me mjedisin ku jetojnë dhe punojnë, ai po ashtu deklaroi se të gjithë pasurin që zotëron se bashku me familjen e tij të ngushtë e ka fituar në mënyrë të ligjshme dhe legjitime dhe se gjatë jetës së tij nuk ka pasur asnjëherë situatë konfliktuale me punëdhënësit dhe punëmarrësit, nga ekzaminimi psikologjik rezultoi se i padituri Q është një person i shëndetshëm psiko-fizikisht dhe here pas here përdor terapi për tu qetësuar nga stresi dhe nervozimi , Q ka tipare pozitive të personaliteti dhe një marrëdhënie të mire ndërtuar personale në ambientin ku punon dhe jeton, gjë që tregon se ia ka dinjitet dhe reputacion e tij në mjedisin ku punon, pas të gjitha këtyre veprimeve të sipër përmendura në procedimin e çështjes ,ekzaminimi psikologjik, shqyrtimit të dosjeve të çështjes, konsultimit të literaturës deklaroi se evidentohet se klienti ka pësuar cenime të dinjitetit personal dhe vuajtje mendore të cilat janë të intensiteti të mesëm dhe kanë zgjatur derisa është zhvilluar procedura hetimore nga organet kompetente , lëndimet e lehta emocionale janë ende të pranishme dhe do të zgjasin deri në përfundim të rastit dhe këto dëmtime mund të kenë ndikim negativ në reputacionin e tij në mjedisin social ku ai punon dhe jeton, e gjithashtu edhe në planin e tij të biznesit si dhe në familje, gjithashtu eksperti me propozimin e palës paditëse në seancën e dt.18.03.2024, ka dhënë sqarimin e tij lidhur me ekspertizën e dt.08.01.2024, për çka gjykata ia ka falur besimin.

Pasi që[pala e paditur kishte vërejtje në ekspertin gjykata të njëjtin në seancën e datës 18.03.2024, ku i njëjti kishte dhen edhe sqarime lidhur me ekspertizën e tij, për çka gjykata konsideron se ekspertiza e punuar nga Psikologu ishte e përpiluar në mënyrë profesionale dhe të njëjtës i fali besimin.

Duke pasur parasysh faktin se pala paditëse e parë kërkon kompensimin e dëmit jo material për shkak se ndaj të njëjtit është ngritur aktakuza me numër 2287/17 të datës 02.11.2017, e cila Aktakuzë ishte refuzuar nga ana e Gjykatës Themelore në Pejë me Aktgjykimin P.nr. 1127/17 të datës 12.12.2019. dhe për paditësen e dytë humbjen e imazhit, e gjithë kjo si rrjedhojë e kallëzimit penal të paraqitur nga e paditura duke u bazuar në neni 182 par. 1 të LMD-së “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.” dhe par 2 po të njëjtit nenë “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Gjithashtu paditësi i par i kërkon shpenzimet e procedurës penale, ndërsa paditësja e par kërkon edhe fitim të humbur dhe pasurim pa bazë e gjitha këto kërkesa palët paditëse i kërkojnë si pasojë e aktgjykimin P.nr. 1127/17 të datës 12.12.2019, të Gjykatës Themelore në Pejë me të cilin është refuzuar aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Me nenin 136 par.1 të LMD-së parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Sa i përket çështjes së dëmit material të pësuar, me nenin 169 të LMD-së par. “4. Gjykata do të gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.”

Andaj duke u bazuar në ne nenin 56 të ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale përcaktohen kompetencat e të paditurës dhe me nenin 69 po të njëjtit ligj përcaktohen edhe kompetencat e Inspektoratit ku të njëjtit duhet të i ndërmarrin veprimet e nevojshme të përcaktuar me ligjin nr. 03/L-163 për M.M, e ku ne rastin konkret duke u bazuar ne nenin 70 par 1 “Nëse një inspektor i autorizuar ka arsye të mira për të besuar se një person është duke ushtruar aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta dhe se ky person nuk posedon Licencë ose Leje nga KPMM, inspektori menjëherë e informon Policinë e Kosovës e cila menjëherë dërgon së paku dy zyrtar policor në vendin e ngjarjes.” dhe par 3 “Nëse asnjëri nga këta persona ose punëdhënësi i tyre (nëse kanë punëdhënësi) nuk posedojnë Licencë ose Leje nga

KPMM, zyrtarët e policisë i arrestojnë Personat në fjalë të cilëve më pas u shqiptohet gjopa administrative e përcaktuar në paragrafin 2 te nenit 79 te këtij ligji dhe dënimet penale sipas Nenit 80 të këtij ligji. Përveç kësaj, inspektori konfiskon të gjitha mjetet punuese dhe mineralet e nxjerra që gjenden në vendin e rastit” e lidhur me nenin 80 ku përcaktohen dënimet dhe se nëse një person vepron në kundërshtim me këtë ligj konsiderohet vepër penale. Pra e padatuara ka vepruar në bazë të kompetencave të saj duke zbatuar ligjin për M.M duke paraqitur kallëzim penal ndaj paditësit të par. Mirëpo duke pasur parasysh se aktakuza penale është ngritur nga Prokuroria Themelore në Pejë e ku organ kompetent për të ngritur aktakuzë është vetëm prokuroria e ku e njëjta në bazë të nenit 234 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale i cili përcakton se “Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjykatës mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit” pra e paditur këtu ka parashtruar vetëm kallëzimin penal dhe aktakuza ka ardhur si rrjedhojë e hetimeve nga ana e prokurorisë pasi që e paditura nuk ka kompetenca ligjore që të parashtrroj aktakuzë, dhe meqë se e njëjta nuk ka qen organ i cili ka ngritur aktakuzë dhe njëherit i mungon edhe legjitimiteti real pasiv për kompensimin e këtij dëmi të pretenduar nga pala paditëse. Gjithashtu pala paditëse ka pasur mundësi ligjore që të veproj edhe konfirmo nenit 382 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sa i përket shpenzimet e procedurës penale të kërkuara nga paditësi i par gjykata të njëjtën kërkesë e refuzoj pasi që e njëjta është e pa bazuar e ku në bazë 449 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës përcaktohen shpenzimet për çka këtu e paditura nuk ka ndikuar në krijimin e këtyre shpenzimeve pasi që procedura penale ka ardhur si rrjedhojë e aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Pejë.

Kërkesa e paditëses së dytë që e paditura të kthej shumën e inkasuar në procedurë përmbartimore P.nr. 215/19 në shumën prej 6.616,06 euro e njëjta është e pa bazuar pasi që ekzekutimi i kësaj shume ka ardhur si pasoj e aktvendimit me numër protokollit 4186 të datës 22.09.2017, ku i është shqiptuar gjopa, dhe pala paditëse ka parashtruar ankesë kundër të njëjti, mirëpo me Aktvendimin numër K.A. nr. 010/2018 të datës 16.01.2018, i është refuzuar ankesa, për çka këtu pala paditëse ka pasur mundësi ligjore që të atakoj këtë vendim me anë të cilit i është refuzuar ankesa dhe të inicioj Konfliktin Administrativ pran gjykatës kompetente siç përcaktohet me nenin 84 të Ligjit për M.M “Çdo vendim apo veprim i KPMM-së, Ministrisë ose cilitdo Autoritet tjetër publik i cili është marrë në bazë të autorizimit të këtij ligji i nënshtrohet edhe shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor si dhe ankesës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parapara në Ligjin për Procedurën Administrative”, e ku palët paditëse nuk kanë dorëzuar ndonjë provë konkrete me anë të cilës do të vërtetohej fakti që vendimi mbi bazën e së cilit është inkasuar kjo shumë e që pala paditëse pretendon se e paditura është pasuruar pa bazë është anuluar duke pasur parasysh se me nenin 194 të LMD-së përcakton se par. 1 “Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur” par 2 “Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve.” Dhe par 3 “Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket” pra në rastin konkret për të kërkuar kthimin e mjeteve për të cilat

pala paditëse pretendon si i janë marrur pa bazë ligjore nga e paditura fillimisht është dashur që vendimi me numër protokollit 4186 të datës 22.09.2017, të anulohet në mënyrë që të konsiderohet pasurim pa pazë. Gjithashtu palët paditëse ka pasur mundësi të kërkoj edhe kundër përmbarrimit nëse vendimi i tillë është anuluar siç përcaktohet me nenin 54 të ligjit për Procedurën Përmbarrimore.

Gjithashtu sa i përket kërkesës për fitim të humbur për periudhën kohore nga data 05.09.2017 deri me datë 15.09.2017, sipas urdhëresës së inspektoratit të KPMM-së të datës 05.08.2017. duke u bazuar në nenin 70 të Ligjit për M dhe M, i cili përcakton kompetencat e Inspektoratit që të nderprej punimet e që janë duke u zhvilluar pa leje përkatëse që lëshohet nga KPMM e ku në bazë të raportit me numër protokollit 10805 të datës 07.09.2017, është konstatuar se palët paditëse kanë vepruar pa leje përkatëse siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Miniera dhe Mineral, e duke u bazuar në këtë rrethanë e lidhur me nenin 173 par. 3 të LMD-së i cili përcakton se *“Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin”* duke pasur parasysh këtë dispozitë gjykata ka marr provën me ekspertizë financiare e ku në bazë të njëjtës është vërtetuar lartësia e fitimit të humbur nga paditësja e dytë, mirëpo kjo e drejt nuk i takon pasi që për të konsideruar fitim të humbur duhet te jetë i anuluar fillimisht urdhri për ndërprerjen e punimeve e ku ne rastin konkret pala paditëse nuk ka dorëzuar prova me anë të cilave do të vërtetohet se i njëjti urdhër është anuluar apo shfuqizuar, dhe vetëm refuzimi i aktakuzës së prokurorisë nga ana e Gjykatës nuk nënkupton se pala e paditur ka përgjegjësi për të kërkuar kompensimin dhe fitimin e humbur, pasi që në këtë situatë mund të mos ketë vepër penale, mirëpo vendimet administrative të marruara nga e paditura e të cilat janë në fuqi dhe kanë prodhuar efekt juridik ndaj paditëseve për çka të njëjtat është dashur të atakohen siç përcaktohet me dispozita ligjore e nëse të njëjtit do të ishin anuluar atëherë palës paditëse dhe i lindte e drejta për të kërkuar këtë lloj të kompensimit të dëmit, e ku pala paditëse nuk ka ofruar asnjë prove që do të vërtetonte se këto vendime janë anuluar, e duke u bazuar në nenin 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Gjykata mund të kërkoj nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së ”.* Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i pati parasysh edhe provat tjera të cilat ishin në shkresa të lendes mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridiko civile.

Vendimin që secila palë të i bartë shpenzimet e veta procedurale, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e palëve në procedurë ku pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe i ka specifikuar mirëpo e njëjta e ka

humbur kontestin ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për çka edhe gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:295285 - C.nr.1640/19, 12.04.2024**

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 dite, nga dita e pranimi, në Gjykatën
e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.